

**ARTI
FIGURATIV
PËR KLASËN
E**

4

Autor: Danço Ordev

Botues: MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË
rr. Mito Haxhi-Vasilev Jasmin, pn

Recensentë: Maja Raunik Kirkov-kryetar
Kasiopea Naumovska-anëtare
Ilija Kočovski-anëtar

Përkthyes:
Fikrije Qerimi

Redaktim profesional:
Prof. Dr. Agim Poloska

Lektor i botimit në shqip:
Rolland Poloska

Shtyp: Qendra grafike shpkp, Shkup

Lektor i botimit në maqedonisht:
M-r Elizabeta Rallpovsla

Dizajn grafik:
Prof. Danço ORDEV
Jovan ALEKSOVSKI

Përgatitja kompjuterike:
Jovan ALEKSOVSKI

Tirazhi: 6.700

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 10-1609/1 të datës 19.06.2009, lejohet përdorimi i këtij libri.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св.Климент Охридски" , Скопје
ОРДЕВ, Данчо
Ликовно образование за 4 одделение / Данчо Ордев. - Скопје :
Министерство за образование и наука, 2009. - 87 стр. : илустр. во боја ; 29 см
ISBN 978-608-4575-33-7
373.3.016:73(075.2)=163.3
COBISS.MK-ID 79205898

NXËNËS I DASHUR,

Ky libër është kushtuar që të të ndihmojë për mësimin e artit figurativ. Qëllimi i tij është që të shtyjë në botën e çudirave të artit figurativ. Në këtë libër janë përpunuar përmbajtje të ndryshme, të cilat teoretikisht dhe vizuelisht do të njohtojnë me krijimtarinë figurative, me gjuhën figurative, me materialet dhe teknikat, me shprehje të caktuara figurative dhe krijimtarinë dhe emrat e artistëve të njohur figurativ nga vendi dhe bota.



Nga ky libër do të kuptosh se arti figurativ ndahet në zona figurative e ato janë: vizatim, pikturë, formësim plastik, grafikë dhe dizajn. Gjuha figurative do të njohtojë me elementet dhe parimet figurative prej të cilave është e formuar një vepër figurative.

Nëpërmjet reproduksioneve që janë përfshirë në faqet e librit, të veprave botërore figurative nga artistë botërorë dhe të vendit, analizoni përmbajtjet e gjuhës figurative, do të shohësh në cilën mënyrë ata i kanë shfrytëzuar veprat e tyre.

Në veprat tua figurative, përdore ato që e ndjen në vehte.

Shpresoj se do të kënaqesh në krijimin e veprave të bukura figurative, e lënda e artit figurativ do të paraqet kënaqësi.

Autori



AUTOPORTRETE TË ARTISTËVE FIGURATIV TË NJOHUR

5



Lazar Liçenoski: **Autoportret**,
vaj në pëlhurë




Albreht Direr: **Autoportret**,
vizatim



Vinsent van Gog: **Autoportret**,
vaj në pëlhurë




Francisko Goja: **Autoportret**,
vaj në pëlhurë



Endi Vorhold: **Autoportret**,
grafikë



M. Milutinović:
Autoportret, vaj në pëlhurë



AUTOPORTRETI IM

(emri)

(mbiemri)

(klasa)

(shkolla fillore)
(vizato autoportretin personal në
hapësirën e zbrazët)



Mikelanxhelo: **Avuoportret**, vizatim

PËRMBAJTJA

6




ARTI FIGURATIV	8
GJUHA FIGURATIVE	10
Vija.....	12
Ngjyra	14
Ton.....	16
Tekstura.....	18
Kahja	20
Madhësia.....	22
Forma-vëllimi	24
Hapësira	26
Kontrast	28
Ritëm-përsëritje	30
Harmonia.....	32
Baraspesha	34
Gradacioni	36
Proporcioni	38
Bashkësia.....	40
Kompozimi.....	42
Motivi	44



SFERAT FIGURATIVE	50
VIZATIM.....	52
Vija.....	54
Tekstura.....	55
Hapësira	56
Ritmi	57
Baraspesha	58
Tush.....	59

PËRMBAJTJA


7



PIKTURIMI	60
Ngjyra	62
Gradacioni	63
Gvash	64
Kolazh.....	65



GRAFIKA.....	66
Monotipia	68
Karton-Shtyp.....	69



FORMËSIM	70
Forma	71
Baraspesha	72
Ngjyra	73
Proporcioni	74
Kompozimi.....	75



DIZAJN DHE KOMUNIKIME VIZUALE	76
GALERI E ARTISTËVE MAQEDONAS.....	78
FJALOR I NICIONEVE	80
TEST 1	83
TEST 2	85

ARTI FIGURATIV

ELEMENTE DHE PARIME FIGURATIVE

8



MUZIKA



LETËRSIA



BALETI

- Njeriu merret me profesione dhe zanate të ndryshme. Në botë ka aq shumë profesione të ndryshme që është rëndë të numërohen. Një është e sigurtë, të gjithë ne me punën tonë ndihmojmë njëri-tjetrin në jetën e përditshme dhe prodhojmë njëri për tjetrin. Një pjesë e njerëzve merren me art. Ata i quajmë artistë. Veprat e artistëve e zbukurojnë kohën tonë të lirë në jetë dhe njeriun e bëjnë të lumtur. Kemi njohuri për arte të ndryshme, muzika, teatri, baleti, letërsia, fotografia e mes tyre bën pjesë edhe arti figurativ.

- Arti muzikor na përcjell në jetë edhe nëpërmjet bukurisë të zërit dhe melodisë e përmbush përditshmërin tonë.



TEATËR

- Arti teatror nëpërmjet lëvizjeve dhe fjalimeve në skenë e pasurojnë jetën tonë me përjetime të veçanta.

- Baleti nëpërmjet bukurisë së gjuhës së trupit, lëvizjeve dhe muzikës na ambush me bukuri të veçantë dhe përjetim.

- Filmi është art pa të cilin njeriu i sotshëm nuk mund ta paramendojë jetën e vet. Filmi është i praqnishëm në secilin vend dhe e plotëson kohën tonë të lirë.

- Letërsia nëpërmjet krijimtarisë së vet dhe bukurisë së fjalës e pasuron jetën tonë shpirtërore, e cila nuk mund të paramendohet pa librin si mik i njeriut.

- Nëpërmjet fotografisë njeriu njohet me botën si dokument dhe pamje vizuale.



FILM



FOTOGRAFIA

ARTI FIGURATIV

ARTI FIGURATIV

10


9




SKULPTURA




VIZATIM



FRESKA



FOTOGRAFI



RELIEV

• Veprat e artit figurativ punohen nga maetriaie të ndryshme dhe na shërbejnë që ta zbkurojmë hapësirën ku jetojmë, mësojmë dhe punojmë. Njeriu prej fillimit të njerëzimit e deri më sot ka punuar vepra artistike prej materialeve të ndryshme. Artin figurativ mundemi ta përjetojmë me shikim, e disa vepra edhe me prekje.



PIKTURË



GRAFIKË



SKULPTURA



DIZAJN

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

10

Të gjitha artet i njohim sipas ndonjë specifike, muzikën sipas zërit dhe melodisë, letërsinë dhe teatrin sipas fjalës, baletin sipas lojës, e filmin sipas ngjarjes. Të gjitha artet shprehen me diçka specifike, e po ashtu edhe artin figurativ. Shprehjen e artit figurativ e quajmë gjuhë figurative. Gjuha figurative është shumë e lehtë që të mësohet. Ajo ndahet në elemente figurative dhe parime figurative. Në këtë libër do të njohetemi në veçanti me secilën prej tyre, e nëpërmjet vizatimit, pikturimit dhe skulpturimit do t'i paraqesim veprat tona figurative. Elementet dhe parimet figurative janë shumë të thjeshta për t'u kuptuar, dhe shumë do të na ndihmojnë që të shprehemi në mënyrë figurative, si dhe ta kuptojmë artin figurativ. Elemente figurative të gjuhës figurative janë: vija, ngjyra, toni, tekstura, kahja, madhësia, forma (vëllimi) dhe hapësira. Parimet figurative janë; kontrasti, ritmi, harmonia, baraspesha, gradacioni, proporcioni, bashkësia dhe kompozimi.



VIJA

Vija bën pjesë në elemente dhe atë e dallojmë si gjurmë në bazën kur vizatojmë dhe shkruajmë.




NGJYRA

Ngjyrën e takojmë në të gjitha anët rreth nesh dhe ajo i ngjyros me ngjyra të bukura të gjitha sendet që i shohim dhe na rrethojnë.



TEKSTURA

Tekstura është paraqitje e sipërfaqeve të rrafshta dhe të vrazhda në ndonjë send.



MADHËSIA

Madhësia është element, i cili na tregon se sendet rreth nesh janë më të vogla apo më të mëdha.



KAHJA

Kahja është drejtim i shikimit të një vizatimi, pikturë, skulpturë apo grafike.



FORMA

Formën tani më e dimë. Të gjitha sendet, edhe ne kemi formë dhe sipas saj njihemi.



TONI

Ton do të thotë ngjyra më të errëta apo më të ndritshme të një ngjyre të njëjtë. Ai fitohet shumë lehtë me përzierjen e ngjyrës me të bardhë dhe të zezë.



HAPËSIRA


Hapësira paraqitet në pikturë. Si hapësirë emërohet gjithë ajo nëpër të cilën lëvizim ne, zogjtë, automjetet Bimët rriten lirisht.

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02

11



KONTRASTI

Kontrasti është parim figurativ. Ai do të thotë diçka e kundërt, sikur dritë-errësirë, e madhe – e vogël, posht – lart, ngrohtë – ftohtë etj.




GRADACIONI

Gradacioni ndoshta është fjalë e re, por me të mësojmë se si në veprën artistike, gradualisht ndryshohen ngjyrat, vijat, tonet dhe elementet tjera.



BASHKËSIA

Bashkësia si parim e rregullon veprën figurative në një tërësi të qetë.



RITMI

Përsëritjen apo ritmin e hasim në çdo vend, në muzikë tonet kanë ritëm, dita dhe nata përsëriten, javët, muajt dhe vitet, etj.



HARMONIA

Harmoni do të thotë si veprën figurative ta bëjmë harmonike dhe të bukura.

KOMPOZIMI
Kompozimi është parimi i fundit, i cili na mëson se si t'i radhisim vijat, ngjyrat, tonet në veprën tonë figurative.



PROPORCIONI

Proporcioni na tregon se si ti bëjmë madhësitë e ndryshme në vëpër harmonike në një tërësi.



BARASPESHA

Baraspesha si parim do të na tregojë se si të jetë vepra e matur, e radhitja në të e barabartë.

VIJA

Vija është elementi i parë me të cilin shprehemi në krijimtarinë figurative. Vijën e shohim në gjitha anët rreth nesh, në natyrë, bimë, objekte, figura dhe në të gjitha sendet që na rrethojnë. Me vija shkruajmë tekste dhe komunikojmë ndërmjet veti.

Vijat i ndajmë në të drejta dhe të lakuara, por mund të jenë edhe të trasha dhe të holla, të shkurta apo të gjata.


Dallojmë vija teksturale dhe konturale. Me vijat konturale paraqesim pamjen e jashtme dhe formën e objektit apo asaj që e paraqesim. Vija teksturale na paraqet karakterin e sipërfaqes të objekteve që i vizatojmë, a janë të vrazhda apo të rrafshta. Varësisht nga dendësia e vijave dhe mënyra se si i shënojmë dhe e paraqesim teksturën në material.



Vijë në natyrë



Vijë me materiale të ndryshme



Vijë gjatë shkrimit



Vijë në jetën e përditshme

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02

13



Vija të drejta dhe të lakuara



Vijë konturale



Vijë teksturale



Vija të drejta, të lakuara, të trasha, të holla, të shkurtera dhe të gjata




Vasko Tashkovski: **Dru në periferi**, vizatim



Ordan Petleski: **Gunga**, tush, Pendë



Skicë ideore për veshmbathje



Vizatim i fëmijëve, vijë teksturale dhe konturale

NGJYRA

Ngjyrën e takojmë në gjitha anët rreth nesh, në natyrë, në objektet dhe gjithçka që ekziston në botë, kanë ngjyrë. Ngjyra shihet vetëm kur ka dritë, natyrore apo artificiale.

Pa dritë nuk ka ngjyrë.

Ndarja e parë e ngjyrave është në ngjyra primare dhe sekondare.

Ngjyra primare janë: e kuqja, e kaltërta dhe e verdha. Prej tyre me përzierje të përbashkët mund të fitohet ndonjë nga ngjyrat sekondare, për shembull e gjelbër, vjollce dhe portokalle.

Në gjuhën greke ngjyra quhet “hroma” dhe nga ajo fjalë të gjitha ngjyrat i quajmë ngjyra hromatike. Në gjuhën figurative e bardha dhe e zeza nuk janë ngjyra, por ato paraqesin ndritshmëri apo errësirë. Për këtë shkak e bardha dhe e zeza quhen ngjyra ahromatike.

Kur pikturojmë mundemi të përdorim ngjyra, të cilat janë të ngjashme njëra me tjetrën apo ngjyra që janë në kontrast.

Nëse pikturojmë me ngjyra të ngjashme themi se shfrytëzojmë ngjyra harmonike, ndërsa kur pikturojmë me ngjyra të kundërta atëherë themi se pikturojmë kontrast.

Te ngjyrat dallojmë lloje të ndryshme të kontrastit mes të cilëve më i njohur është kontrasti komplementar. Në këtë kontrast ngjyrat ndërmjet veti forcohen dhe janë më të shprehura dhe më të bukura.


Ngjyra komplementare ndërmjet veti janë e gjelbëra dhe e kuqja, e kaltërta dhe portokalle, e verdha dhe vjollce.



Ngjyra në natyrë fotografiia



Harmoni me ngjyrat



Ngjyra ahromatike



Pablo Pikaso: **Algjeriane**, vaj në pëlhurë Ahromatski boi platno (ngjyra hromatike)




Dragan Najdenovski: **Rajoni 607**, vaj në pëlhurë (ngjyra harmonike)

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02


15



Ngjyra primare dhe fitimi i ngjyrave sekondare



Rreth i ngjyrosur



Çifte komplementare të ngjyrave




Dritë –ngjyrë e bardhë



Errësirë-ngjyrë e zezë



Ngjyra komplementare **Lule**,
fotografi (e kuqe dhe e gjelbër)



Endi Varhold: **Merlin**,
Ngjyra kontrast


TON

Toni është pjesë e ngjyrës. Prej një ngjyre mundemi të fitojmë tone të ndritshme dhe të errëta. Toni është sasi e ndritshmërisë në një ngjyrë.

Nëse në një ngjyrë gradualisht shtojmë nga pak ndritshmëri, respektivisht ngjyrë të bardhë, do të fitojmë ngjyrë më të ndritshme.

Nëse gradualisht shtojmë nga pak errësi, respektivisht ngjyrë të zezë, do të fitojmë ngjyra më të errëta. Për shembull, nëse ngjyrës së kaltërt gradualisht i shtojmë ngjyrë të bardhë do të fitojmë tone më të ndritshme, e nëse gradualisht i shtojmë ngjyrë të zezë atëherë do të fitojmë tone më të errëta të së kaltërtës.

Sikurse te ngjyra, po ashtu edhe te toni dallojmë tone hromatike dhe ahromatike. Nëse ngjyrave hromatika u shtojmë ngjyrë të bardhë apo të zezë do të fitojmë tone hromatike. Nëse i përziejmë së bashku të bardhën dhe të zezën atëherë do të fitojmë tone ahromatike.



Shkallë tonale hromatike

Goce Bozhurski: **Pikturë**, vaj në dru (tone harmonike)

Tone ahromatike

Gjoko Matevski: **Shtangime**, vaj në pëlhurë (ton)

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02


17




Tone hromatike



Shkalla hromatike e toneve të së kaltërtës



Shkalla ahromatike e toneve



Toni në natyrë, fotografi



Rembrant: **Apostol**, vaj në pëlhurë (ton)



K. Kaçev: **Adam**,
Vaj në pëlhurë

TEKSTURA


Sipërfaqen mundemi ta shohim ose ta ndiejmë me prekje. Me shikim apo me prekje mundemi të dallojmë se sipërfaqja është e vrazhdë, e lëmueshme, e këndshme, e pakëndshme, e fortë, e lagur apo e thatë.

Nëse sipërfaqen e paraqesim në vizatim, pikturë, grafikë apo skulpturë, rezultatin e quajmë teksturë.

Artistët në vizatimet dhe teksturat e tyre shprehen me përdorimin e vijës. Që të paraqesin materiale me teksturë të ndryshme përdoren vija të trasha, të holla, të gjata, të shkurta, të drejta dhe të lakuara.

Vijat vizatohen në mënyra të ndryshme, më rrallë dhe më dendur, më trashë dhe më hollë, dhe në atë mënyrë fitohet iluzion i teksturës. Për këtë qëllim shfrytëzohen materiale dhe teknika të ndryshme.


Tekstura fitohet edhe në pikturim, me shfrytëzimin e ngjyrës, në grafikë me vijën dhe sipërfaqen si dhe në skulpturë me gdhendje dhe thellësim.



Teksturë e punuar me ngjyrë




Teksturë natyrale



Teksturë në materiale artificiale



Teksturë natyrale në gur.



Teksturë natyrale

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02

19




Teksturë me vijë




Dushan Xhamonja: **Skulpturë metali 73**,
Teksturë me vijë metali (teksturë)




Ordan Petleski: **Bërthamë me proces**, vaj në pëlhurë (teksturë)



Risto Kalçevski: **Piktura 21-76**, vaj në pëlhurë (teksturë me ngjyrë)



Kalçev: **Piktura 1-1369**, vaj në pëlhurë (teksturë)



Krijim i fëmijëve (teksturë me ngjyrë)

KAHJA

Njeriu lëviz në ndonjë drejtim. Drejtimi apo kahja se ku shkojmë varet nga qëllimi ynë. Edhe syri ynë gjithë kohën lëviz në ndonjë kahje. Shohim para vehtes, majtas dhe djathtas, lart dhe posht.

Kur shohim ndonjë dru, syri ynë lëviz lart-posht. Nëse shohim tren apo rrugë ose lumë, kahja jonë e shikimit është majtas-djathtas, respektivisht ajo është horizontale. Kur shohim aeroplan duke ateruar apo fluturon, kahja e shikimit tonë është e pjerrët.

Edhe në artin figurativ kemi element figurativ, i cili quhet kahje. Ajo varet nga ajo se si lëviz syri ynë kur shohim ndonjë vepër artistike.

Në vepër kemi vija, ngjyra dhe sipërfaqe, të cilat e lëvizin syrin tonë në ndonjë drejtim. Varësisht nga ajo se si lëviz syri ynë dallojmë kahje horizontale, vertikale dhe të pjerrët. Por ka edhe vepra të tilla ku syri ynë mbetet brenda në vepër, sepse nuk ka forcë e cila e cakton kahjen. Atëherë themi se vepra është pa kahje.

Nëse i shohim me kujdes veprat e paraqitura në këtë libër do të shohim se në cilat kahje na lëviz syri.



El Greko: **Kryqëzimi i Krishtit**, vaj në pëlhurë (kahje vertikale)



Konjoviq: **Drith**, vaj në pëlhurë (kahje horizontale)



Francisko Goja: **Maja e veshur**, vaj në pëlhurë (kahje e pjerrët)



Vepër pa kahje

GJUHA FIGURATIVE


ELEMENTE FIGURATIVE

02

21




Bernardo Stochi: **Lahutari**, vaj në pëlhurë (kahje e pjerrët)



Vladimir Georgievski: **Viç i artë**, vaj në pëlhurë (kahje vertikale)




Vepër me kahje të pjerrët



Tanja Tanevska: **KA NA**, Teknikë e kombinuar (kahje vertikale)



Mark Shagal: **Ditëlindje**, vaj në pëlhurë (kahje e pjerrët)



Vepër pa kahje



Tanja Balak: **Disa tregime**, vaj në pëlhurë (kontrast i kahjes)


MADHËSIA

E gjithë ajo që na rrethon ka madhësi të caktuar, më të vogël apo më të madhe. Të gjitha madhësitë në botë themi se janë relative, varësisht se cilën madhësi me çka e krahasojmë.


Ju fëmijët e kësaj klase jeni më të vegjël nëse krahasoheni me fëmijët e klasave më të larta apo me të rriturit, por ju jeni me të mëdhenj nëse krahasoheni me fëmijët e foshnjores. Një ndërtesë mund të themi se është e madhe nëse e krahasojmë me ndonjë më të vogël, por mund të them se është e vogël nëse e krahasojmë me ndonjë më të madhe.

Të gjitha madhësitë mund të jenë më të mëdha apo më të vogla, vetëm varet se me çka i krahasojmë.

Në secilën vepër figurative shfrytëzojmë madhësi të ndryshme të formave, ngjyrave dhe toneve me qëllim që të krijojmë kompozim të bukur.




Vepër me madhësi të njëjta



Vepër me madhësi dhe forma të ngjashme



Vepër me madhësi të ndryshme




Nëse e krahasojmë madhësinë nr. 4 me madhësinë nr. 3, ajo është më e madhe, por nëse e krahasojmë madhësinë e njëjtë me madhësinë nr. 5 ajo është më e vogël.

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE


20

23



Teo Van Dizburg: **Lojtar me letra**, vaj në pëlhurë (madhësi të ngjashme)

Pit Mondrijan: **Tablo II**, vaj në pëlhurë



Dushan Xhmonja: **Skulptura 73**, metal



Vepër me madhësi dhe ngjyra të ngjashme



Jan Helion: **Kompozim**, vaj në pëlhurë (forma të ngjashme)

FORMA

Rreth nesh ekzistojnë shumë forma të krijuara nga natyra apo njeriu. Format e natyrës i quajmë natyrale, ndërsa format e krijuara nga njeriu i quajmë artificiale.

Forma është pamja e jashtme e ndonjë forme të paraqitur në vizatim, pikturë, grafikë apo skulpturë.

Dallojmë forma dydimenzionale dhe tredimensionale. Format dydimenzionale kanë ato forma, të cilat krijohen kur ajo vizatohet në hapësirë dydimenzionale (vizatim, pikturë, grafikë, mozaik apo vitrazh).

Formë tredimensionale është kur me ndonjë material të fortë apo të butë formohet objekt artistik në hapësirë (skulptura, keramika, argjili, druri, guri apo objekt në arkitekturë).

Forma tredimensionale zë vend të caktuar në hapësirë. Atë hapësirë e quajmë vëllim. Vëllimi në skulpturë mund të jetë i zbrazët, i mbushur me ajër apo me material prej të cilit është punuar skulptura. Nëse vepra është e plotë me material themi se ka masë sa vëllimi. Për shembull, topi ka vëllim më të madh se masa prej të cilës është punuar, ndërsa guri ka masë më të madhe se vëllimi.



Forma natyrale



Forma artificiale



Vizatim (formë dydimenzionale)



Portret i Artemidor, fotografi e sarkofagut (formë dydimenzionale)



Skulpturë argjili (formë tredimensionale)

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02

25




Freskë egjiptase
(formë dydimenzionale)



Lajmi i ëmbël i Shën Mërisë , ikonë,
Ohër (formë dydimenzionale)



B. Miljush: **Nostalgji**, grafikë
(formë dydimenzionale)



Dimo Todorovski: **Nëna e artistit**,
bronzë (formë tredimensionale)



vëllim

Formë, e cila merr vëllim të
caktuar me masë më të vogël.



masë

Formë, e cila merr vëllim dhe
masë të njëjtë



Pavle Kuzmanovski: **Dëshmitar**, vaj në pëlthurë
(formë dydimenzionale)

HAPËSIRA

Çdo gjë që na rrethon është hapësirë. Në hapësirë lëvizim, zbavitemi, flejmë, jetojmë. Rruga, shkolla, banesa, fusha, mali, e gjithë kjo është hapësirë. Këtë hapësirë e quajmë hapësirë reale, për shkak se ekziston dhe ne lëvizim në atë hapësirë.

Ekziston hapësirë e brendshme dhe e jashtme. Hapësirë e brendshme apo e mbyllur është secila hapësirë e krijuar nga njeriu, që t'i shërbejë për ndonjë qëllim. Hapësirë e jashtme apo e hapur është ajo hapësirë ku mundemi të lëvizim pa kufizim, e ajo është natyra, qielli, rruga, parku, sheshi, mali, fusha etj.

Artistët në veprat e tyre mundohen të paraqesin hapësirën. Paraqitja e natyrës në vizatim, pikturë apo grafikë quhet iluzion në hapësirë.



Hapësirë reale e hapur



Natyra, hapësirë reale e jashtme, fotografi



Qytet, hapësirë e hapur reale, fotografi



Skicë për hapësirë të brendshme



Galeri hapësirë reale e mbyllur, fotografi

GJUHA FIGURATIVE

ELEMENTE FIGURATIVE

02


27



Piter Brojgel: **Kthimi i bagëtisë**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë)



Piter Brojgel: **Pejsazh nga Egjipti**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë)



Dimitar Pandilov: **Tren i ngarkuar**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë)



F. Pavlovec: **Rajon dimri**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë)



Iluzion në hapësirë të hapur me ton



Tomo Vladimirov: **Motiv nga Praga**, vaj në pëlhurë (iluzion në hapësirë)

KONTRAST

Kontrasti në jetën e përditshme do të thotë kur krahasojmë dy gjëra, të cilat ndërmjet tyre janë të kundërta, për shembull: e madhe dhe e vogël, errësirë dhe dritë, lart dhe poshtë, e trashë dhe e hollë etj.

Kontrasti është parim figurativ, i cili mund të aplikohet në të gjitha elementet figurative, me vija, ngjyrë, ton, kahje, teksturë etj.

Në veprën figurative mundemi të përdorim kontrast të vijave (të trasha dhe të holla, të drejta dhe të lakuara, të shkurtëra dhe të gjata), kontrast të ngjyrave (të errëta dhe të ndritshme, të ngrohta dhe të ftohta), kontrast të toneve të errëta dhe të ndritshme, kontrast i formave të mëdha dhe të vogla, të rumbullakëta dhe këndore, kahje horizontale dhe vertikale etj.



Vasilij Kandinski: **Improvizimi 6**, vaj në pëlhurë (kontrast i ngjyrave)



Kontrast i vijave



Kontrast i toneve ahromatike



Kontrast bardh e zi

GJUHA FIGURATIVE

PARIME FIGURATIVE

02


29




Vasilij Kandinski: **Kompozimi IX**, vaj në pëlhurë
(kontrast i madhësisë dhe formës)



Kontrast i ngjyrave të ngrohta dhe të ftohta



Kontrast i teksturës



Edvard Munk: **Pubertet**, vaj në
pëlhurë (kontrast i kahjes)



Endi Vorhold: **Lule**,
(kontrast i ngjyrës)

RITMI


Shumë sende në natyrë dhe në jetën tonë përsëriten. Përsëritet dita dhe nata, javët, muajt, vitet, stinët e vitit. Përsëriten shprehjet tona, veshmbathja, gjumi dhe shkuarja në shkollë. Këtë përsëritje e quajmë ritëm. Gati se çdo gjë në natyrë dhe në jetën tonë ka ritëm.

Edhe në artin figurativ kemi parim të cilin e quajmë ritëm apo përsëritje. Ritëm në art është kur ndonjë element figurativ përsëritet në veprën artistike.


Përsëritja shpesh herë takohet në punimet popullore, në veshjet popullore, në arkitekturë, në natyrë dhe te sendet ,që i përdorim në jetën e përditshme. Dallojmë ritëm të thjeshtë dhe alternativ.

Ritëm i thjeshtë është kur një element përsëritet shumë herë pa e ndryshuar madhësinë, formën dhe ngjyrën.

Ritmi alternativ është kur kemi përsëritje të shumtë, por elementi që përsëritet nuk është i njëjtë, apo përsëriten dy elemente të ndryshme.



Ritëm i rregullt



Ritëm alternativ



Qëndisje popullore maqedonase (ritëm i formës dhe ngjyrës)

Vepër kompjuterike,
ritëm alternativ

GJUHA FIGURATIVE


PARIME FIGURATIVE

02


31



Endi Vorhold: **Mona Liza**, akril në pëlhurë (ritëm)



Simon Shemov: **Vështrim i yjeve**, grafikë (ritëm alternativ)



Art islamiik
(ritëm i formës dhe ngjyrës)



Ritëm në arkitekturë



Qëndisje maqedonase popullore
(ritëm alternativ i rregullt)

HARMONIA

Harmonia është e nevojshme në të gjitha sferat e jetës, në natyrë, në jetë, në raportet mes njerëzve dhe harmonia e personalitetit tonë.

Harmonia është parim në artin figurativ.

Ky parim figurativ mundëson të fitohet harmonia në veprën figurative, në vizatim, pikturë, grafikë dhe skulpturë.

Harmoni në një vepër figurative mund të arrijmë nëse shfrytëzojmë vija të ngjashme, ngjyra të ngjashme, tone të ngjashme, tekstura, madhësi etj.

Harmonia e arritur me shfrytëzimin e vlerave të ngjashme quhet harmoni analoge.



Nehat Bekiri: **Gjurmë**, akril në pëlhurë (harmoni me ton)



Harmoni me vija të drejta



Harmoni me vija të lakuara



Harmoni me vija të lakuara



Ordan Petleski: **Fantastmagjie 1**, vizatim (harmonia me vija)

GJUHA FIGURATIVE

PARIME FIGURATIVE

02

33



Zhak Vilon: **Ushtarët në Marsh**, vaj në pëlhurë (harmoni me forma dhe ton)



Harmoni me formë dhe ngjyrë




Pit Mondrian: **Dru i kuq**, vaj në pëlhurë (harmoni me ngjyrë, vija dhe formë)



Ilija Kočovski: **Gjueti e kaprojeve**, litografi (harmoni)



Predrag Uroshević: **Vizatim**, (harmoni me vija)



Harmoni me forma



Harmoni me ngjyrë

BARASPESHA

Baraspesha është e nevojshme për të gjithë ne dhe atë që na rrethon. Njeriu synon për baraspeshë mendore dhe fizike, natyra që të ruhet arrin baraspeshë. Ky parim në jetën e përditshme është i rëndësishëm për ruajtjen e tërësinë e jetës dhe mbijetimit të të gjithëve.

Baraspesha në vepra figurative arrihet me kombinimin e elementeve figurative nga gjysma e majtë dhe e djathtë e veprës në një tërësi.


Tërësinë e arrijmë me anë të simetrisë dhe asimetrisë, sipas kësaj kemi baraspeshë simetrike dhe asimetrike.

Simetria arrihet shumë lehtë dhe thjeshtë, me radhitje identike të elementeve në të dy anët e veprës, me vendosjen e vlerave në mënyrë identike.

Baraspesha asimetrike arrihet kur kemi baraspeshë mes dy gjysmave por me vendosje të ndryshme të elementeve në të dy gjysmat.




Vepër e fëmijëve
(baraspeshë simetrike)



Vepër e fëmijëve
(baraspeshë simetrike)



Kisha, Staro Nagoriçane (simetri)



Tempulli Taxh Mahall (simetri)

GJUHA FIGURATIVE

PARIME FIGURATIVE

02


35




Vepër e fëmijëve (simetri)




Vepër e fëmijëve (simetri)



Vepër e fëmijëve
(baraspeshe asimetrike)



Vepër e fëmijëve
(baraspeshe asimetrike)



Baraspeshë simetrike



Vasko Tashkovski:
Orientim vertikal,
Vaj në pëlhurë
(asimetri)




Baraspeshë asimetrike

GRADACIONI


Gjithçka që na rrethon, edhe ne njerëzit, gradualisht ndryshohemi. Nata gradualisht kalon në ditë dhe anasjelltas, bimët gradualisht zhvillohen, njeriu prej foshnje rritet dhe ndryshohet deri në pleqëri. Gjithçka ndodh gradualisht dhe ngadalë. Kur disa sende gradualisht ndryshohen nga një gjendje në tjetër, nga një pozitë në tjetër, quhet gradacion.

Në gjuhën figurative ekziston parim figurativ i quajtur gradacion.

Ky parim tregon se çdo element figurativ mund të ndryshojë gradualisht çdo element nga një vlerë në tjetër. Toni mund të kalojë nga më i ndritshmi kah më i errëti gradualisht, prej ngjyrës së verdhë të kalojë në të gjelbërt, në të kaltërt, e pastaj në vjollce e deri te e kuqja. Gradacioni në ngjyrë më së miri mund të dallohet te spektri i ngjyrave.



Gradacion me vija



Gradacion me ngjyrë



Gradacion me teksturë

GJUHA FIGURATIVE


PARIME FIGURATIVE

02


37



Ndërtesa e NIP Nova
Makedonija, Shkup
(gradacion në arkitekturë)



Gradacion me formë



Gradacion me teksturë



Kërsto Hegedushiq: **Tre nga Hamburgu**, vaj në pëlhurë (gradacion me ton)



O. Mujaxhiq: **Futboll**, vaj në pëlhurë (gradacion me ton)

PROPORCIONI

Proporcioni është shprehje, e cila cakton raportin ndërmjet madhësive në një tërësi. Artistët figurativë dhe arkitektët çdo herë kanë kërkuar mënyrë se si vepra figurative ose arkitektura të duket më ideale sipas bukurisë dhe me cilat proporcione do ta arrijnë atë.

Në histori artistët dhe arkitektët kanë gjetur proporcionet më të mira në paraqitjen e trupit të njeriut dhe ndërtimin e ndërtesave, tempujve, katedraleve etj.



Poliklet Doriforos, mermer



Proporcion me shkronja



Katedrala në Strazbur



Tempull grek (proporcion)

GJUHA FIGURATIVE

PARIME FIGURATIVE

02

39




Praksitel, Hermes, mermer



Leonardo da Vinçi: **Kanon për proporcionin e trupit të njeriut**



Njeriu si proporcion për sendet në enterier



Proporcion i paraqitjes së trupit të njeriut



Manastir **Joakim Osogovski** (proporcion në arkitekturë)



Shtëpi në Ohër
(proporcion në arkitekturë)

BASHKËSIA

Artistët çdoherë kanë për qëllim të arrijnë që veprat e tyre të kenë një tërësi, të mos ndodhë që vepra të duket si e formuar nga pjesë të ndryshme, të cilat ndërmjet veti nuk janë tërësi. Në artin figurativ ajo arrihet me parimet figurative: baraspesha, harmonia, përsëritja ose kontrast.

Bashkësia si parim figurativ ka për detyrë të njëjtë si parimet tjera ta rregullojë tërësinë në një vepër. Ajo arrihet, përvjeç tjerash, edhe me zbatimin e vlerave të barabarata sikurse te harmonia.



Bashkësi me vija



Bashkësi me vija dhe madhësi



Bashkësi me vija



Bashkësi me ton

GJUHA FIGURATIVE

PARIME FIGURATIVE

02


41




Bashkësi me ngjyrë, formë dhe madhësi




Bashkësi me ngjyrë, madhësi, formë dhe ton




Bashkësi me ton



Bashkësi me madhësi, formë dhe ton



Bashkësi me formë, madhësi dhe ton



Bashkësi me madhësi, ngjyrë dhe formë

KOMPOZIMI

Çdo gjë që është e formuar prej më shumë pjesëve mund të quhet kompozim.


Në muzikë kemi kompozim të toneve, në letërsi kompozim të teksteve etj. Në gjuhën figurative kompozimi është parim figurativ sipas të cilit bëhet radhitja e vendeve të elementeve figurative të përdorura.

Kompozimi arrihet me përdorimin e ngjyrave, toneve, vijave, formave, në një tërësi të radhitura sipas dëshirës së autorit.

Nëse elementet figurative janë të radhitura horizontalisht, përfundojmë se kemi kompozim horizontal, kështu është edhe me kompozimin vertikal dhe të pjerrët.

Kompozim
diagonalKompozim
vertikal

--- Kompozim horizontal



Kompozim i mbyllur



Kompozim horizontal, fotografi



Reliev (kompozim horizontal)


Evangelis Mateja, ikonë, Ohër
(kompozim vertikal)

GJUHA FIGURATIVE

PARIME FIGURATIVE

02

43



Kompozim i mbyllur

Dimçe Nikollov,
grafikë
(kompozim vertikal)



Kompozim diagonal



Reshat Ameti: **Mjedis urban**, vaj në pëlthurë (kompozim vertikal)




Mark Shagal: **Violinist i gjelbër**,
vaj në pëlthurë (kompozim vertikal)

Secila vepër e arti figurativ është e ndërtuar me kombinim të përbashkët të elementeve, siç janë vija, ngjyra, toni, kahja, tekstura, forma, madhësia, hapësira, vëllimi. Në të janë të pranishëm edhe parimet figurative, të cilat i rregullojnë elementet figurative.

Duke shikuar veprën figurative, në të mund të shohim ndonjë përmbajtje të njohur të paraqitur si portret, autoportret, karikaturë, figurë, akt, skena nga jeta e përditshmë, kafshë, enterier, pejsazh apo natyrë e vdekur. Paraqitja e sendeve në vepër quhet motiv.

Nëse në veprën figurative kemi vetëm kombinim të vijave, ngjyrës, toneve, teksturës etj., e nuk ka motiv, themi se ajo është vepër abstrakte, respektivisht pa motiv.



Edo Murtiq: **Pikturë**, vaj në pëlhurë (pikturë abstrakte)



Francisko Goja: **Maja e veshur**, vaj në pëlhurë (pikturë me motiv)

PORTRET

Nëse në veprën figurative është paraqitur fytyrë njeriu themi se motive i veprës është portret. Secili artist kur paraqet portret të ndonjë personi, mundohet që ta paraqet shprehin e tij specifike dhe karakterin, e jo vetëm pamjen fizike.



Leonardo da Vinçi: **Mona Liza**, Vaj në pëlhurë



Vasil Vasilev: **Ana**, dru

AUTOPORTRET

Artistët figurativë shpesh herë e paraqesin fytyrën e tyre nëpërmjet vizatimit, pikturës, grafikës apo skulpturës. Për këtë vepër themi se është autoportret. Autoportreti mund të jetë si vepër figurative e pavarur, e ndonjëherë artistët e kanë pikturuar autoportretin e vet në skena grupore në të cilat është paraqitur ndonjë ngjarje historike. Në këtë mënyrë ne njoftohemi se si është dukur ndonjë artist nga kohërat kur nuk ka pasur fotografi.



Blagoja Nikollovski: **Portret i një plake**, vaj në pëlhurë



Jan van Ajk: **Portret**, vaj në pëlhurë



K. Mijic: **Portret i gruas sime**, vaj në pëlhurë



Nikolla Martinovski: **Autoportret**, vaj në pëlhurë



Vinsent Van Gog: **Autoportret**, Vaj në pëlhurë



Francisko Goja: **Autoportret**



Albreht Direr: **Autoportret**, Vaj në pëlhurë

KARIKATURA

Disa artistë në veprën e tyre paraqesin psikologjinë e njeriut, vetinë qesharake, të pakëndshme apo jonjerëzore të tij. Në këtë paraqitje ndryshohet pamja e personave dhe këtë motiv e quajmë karikaturë.



Onore Domie: **Konte**, bronzë



Onore Domie: **Këtë mundemi qetë ta lirojmë**, litografi

FIGURA

Veprat figurative shpesh na paraqesin figura të veshura njerëzish nga periudha të ndryshme të historisë së njerëzimit.

Figura si motiv ka domethënie të madhe për shkak se është dokument sipas të cilit njohtohemi me mënyrën se si kanë qenë të veshur njerëzit në kohërat e kaluara.



Avgust od Primaporte, Roma, mermer



Eduard Mone: **Frulist**, vaj në pëlhurë



Aamdeo Modiljani: **Njeri me llullë**, vaj në pëlhurë

Jan van Ajk: **Xhovani Arnolfini dhe nusja e tij**, vaj në pëlhurë

AKT

Që nga parahistoria e deri më sot artisti ka vizatuar, pikturuar ose nëpërmjet skulpturës ka paraqitur trupin e mashkullit apo të femrës pa veshmbathje. Pothuajse nuk ka artist që në krijimtarinë e tij nuk e ka paraqitur bukurinë e trupit të njeriut.



Gaston Lashoz: **Gruaja, e cila qëndrin**, bronzë



G. A. Kos: **Dy akte**, vaj në pëlhurë



Hubert van Ajk: **Adami dhe Eva**, pikturë në dru



Dega: **Gruaja që kreh flokët**, pastel

ZHANËR

Shum artist në gjithë krijimtarinë e tyre paraqesin skena dhe ngjarje nga jeta e përditshme në kohën kur kanë jetuar. Nëpërmjet veprave të tyre, ne sot njihemi me jetën e njerëzve gjatë historisë si janë veshur, si dhe ku kanë jetuar, çfarë zakone kanë pasur, me cilat vegla janë shërbyer.

Ky motiv është dokument për kohën në të cilën krijuan vepra.



Sharden: **Kthimi nga tregu**, vaj në pëlhurë



Piter Brojgel: **Dasëm fshatare**, Vaj në pëlhurë

KAFSHË

Disa artistë shumë shpesh në krijimtarinë e tyre kanë paraqitur ndonjë kafshë shtëpiake apo të egër. Paraqitja e kafshëve si motiv e quajmë animalizëm.

Për paraqitjen e kafshëve artistët kanë qenë të inspiruar nga bukuria e ndonjë kafshe të caktuar apo nga simboli që paraqet ajo kafshë.



Gillgamesh: Zbukurim për kuti



Ulkonja, Romë, bronzë

ENTERIER

Paraqitjen e hapësirës së brendshme e quajmë enterier. Nëpërmjet vizatimit, pikturës apo grafikës artisti e paraqet hapësirën e brendshme të shtëpisë apo të vendeve publike. Nëpërmjet këtij motivi njihemi me pamjen e vendbanimeve dhe vendet tjera në të cilat kanë jetuar njerëzit.



Mjeshtri nga Flamale:
Lajmërimi i mirë, vaj në dru



Vinsent Van Gog: Dhomë,
vaj në pëlhurë


PEJSAZH

Shumë vepra figurative e paraqesin bukurinë e natyrës që quhet pejsazh. Nëpërmjet pejsazhit na janë paraqitur bukuritë e maleve, liqeneve, lumenjve, fushave, fshatrave, qyteteve dhe rrugëve.



Vinsent van Gog: **Lule**, vaj në pëlhurë

Piter Brojgel: **Pejsazh dimri**, vaj në pëlhurë



Danço Ordev: **Ljubanci**, vaj në pëlhurë



Panorama, fotografi



F. Kovačević: **Pejsazh dimri**, vaj në pëlhurë

NATYRË E VDEKUR

Kur artisti figurativ në veprën e tij ka paraqitur sende të ndryshme, bimë apo kafshë të vdekura themi se vepra është me motiv natyrë të vdekur.

Nëpërmjet natyrës së vdekur artistët duan të na paraqesin bukurinë e vlijës, pasurinë e ngjyrës dhe hapësirave në veprën figurative.



Pol Sezan: **Pjeshkë dhe qersh**, vaj në pëlhurë



Vinsent Van Gog: **Fushë gruri**, vaj në pëlhurë

Arti figurativ, sikurse artet tjera, mund të ndahet në më tepër sfera. Varësisht nga ajo se me çfarë materiale punohet dhe çfarë vepra fitohen, artin figurativ e ndajmë në vizatim, pikturim, skulpturë, grafikë dhe komunikim vizuel.

» Vizatimi është sferë e artit figurativ ku punohen vizatime. Kjo sferë shprehet me përdoriimin e vijave të ndryshme.

» Pikturimi si sferë e artit figurativ është shumë e përhapur, e veprat e saj janë pikturat. Pikturat punohen nga materiale të ndryshme me përdorimin e ngjyrës dhe sipërfaqes.

» Në sferën figurative skulpturë apo formësim plastik siç e quajmë, artistët punojnë reljefe skulpturalë. Këto vepra vendosen në hapësirë dhe përpunohen me materiale të ndryshme, të fortë apo të butë.

» Grafika është zonë figurative në të cilën veprat figurative punohen me ndihmën e shtypjes. Këta artistë i quajmë graficistë, ndërsa veprat grafikë.

» Kemi artistë, të cilët e trillojnë pamjen e sendeve për përdorim të përditshëm. Ata trillojnë pamjen e kopertinave dhe ilustrimeve për libra, revista, plakate, ambalazhet e prodhimeve, prodhimet e tekstilit dhe sende të tjera, siç janë automjetet, veglat për amvisëri dhe gjithë ajo që shohim dhe e shfrytëzojmë në jetën e përditshme. Këta artistë quhen dizajnerë.



VIZATIM



PIKTURË



VIZATIM



VIZATIM



PIKTURË

SFERAT FIGURATIVE

ARTI FIGURATIV

04

51



GRAFIKË



SKULPTURË




DIZAJN



DIZAJN



GRAFIKË



SKULPTURË



DIZAJN



DRUGDHENDJE



SKULPTURË



DIZAJN

Vizatimi është sferë figurative në të cilën artisti figurativ shprehet me vizatim. Njeriu ka filluar të vizatojë që nga parahistoria e deri më sot. Në artin figurativ vizatimi llogaritet si vepër artistike dhe shumë piktorë kanë krijuar vizatime shumë të bukura. Por, edhe shumë artistë vizatimin e shfrytëzojnë si përgatitje për përpunim të veprave të tjera figurative, piktura, skulptura dhe grafika. Me vizatim shënohet ideja, bëhet skica e veprës.

Për vizatim mund të shfrytëzohen të gjitha materialet të cilat lënë gjurmë në bazë. Vizatimi mund të punohet me laps, thëngjill, lloje të ndryshme të pastelit, tush i thjeshtë dhe i yndyrshëm, si dhe ngjyra akuarel dhe tempera.



Vizatim me laps



Vizatim parahistorik në shpellën Altamira



Vizatim i fëmijëve me flomaster



Vizatim me thëngjill

Rembrant: **Vizatim**, tush



Vizatim me akualet



Vizatim me thëngjill



Modiljani: **Njeri me mjekër**, tush



Predrag Urosheviq: **Vizatim**



Ordan Petleski: **Vizatim**, tush, pendë



Vizatim me laps

VIJA

Vijën më së shumti e përdorim në vizatim. Vijën mundemi ta përdorim në shumë mënyra në vizatim, varësisht nga ajo se çka duam të paraqesim. Mundemi t'i përsërisim të njejtat apo të ndryshme, në ritëm, ti lidhim mes veti, ti vendosim në vizatim në madhësi, trashësi apo dendësi të ndryshme. Gjatë vizatimit të sendeve të ndryshme me vijë konturale mundemi t'i paraqesim format e tyre dhe pamjet, ndërsa me vijë teksturale sipërfaqet specifike të tyre.

Nëse shfrytëzojmë vija të ngjashme do të fitojmë vizatim harmonik, dhe mundemi të përdorim edhe vija kontraste që të fitojmë llojllojshmëri në vizatim.



Edgard Dega: **Balerina**, tush



Vijë konturale




Vizatim i fëmijëve, tush




Petleski: **Monument**,
vizatim, tush

TEKSTURA


Secilin send që e vizatojmë ka sipërfaqe, e cila mund të jetë e vrazhdë, e lëmuar, e butë etj. Me ndihmën e vijës paraqesim karakterin e asaj sipërfaqeje, e ato vija e dimë se quhen teksturale. Me vija teksturale paraqesim: koren e drurit, gurit, barit, tokës dhe shumë materiale tjera.



Teksturë natyrale



Vijë teksturale



Teksturë me vijë të ngjyrosur



Vijë teksturale



Teksturë natyrale e kores së drurit



Vijë teksturale

HAPËSIRA

Me vizatim mundemi të paraqesim çdo gjë që dëshirojmë, sende të ndryshme, kafshë, njerëz, bimë, natyrë dhe objekte të ndryshme të paraqitura nga jasht dhe brenda.

Duke paraqitur hapësirën me vizatim ne paraqesim iluzion në hapësirë. Me shfrytëzimin e vijave të ndryshme, artistët paraqesin hapësirën e jashtme, respektivisht natyrën siç janë malet, deti, fusha, ndërtesa, qytete, respektivisht objekte në të cilat jetojmë, mësojmë, punojmë apo zbavitemi.


Përveç hapësirës së jashtme, me vizatim paraqesim edhe hapësirën e brendshme, respektivisht pamjen e shtëpisë sonë, klasën, dhomën tonë, e mundemi të bëjmë edhe skica apo plan si të duket banesa jonë.



Vinsent van Gog: **Pejsazh**, tush, pendë (iluzion në hapësirë)



Iluzion në hapësirë me bashkim




Skicë e hapësirës së brendshme




Kërsto Hegedushiq **Kasolle**,
tush dhe pendë

RITËM

Në vizatim, si dhe në krijimet tjera figurative, kemi ritëm të vijave. Nëse në natyrë e shikojmë radhitjen e drunjve do të shohim se kemi ritëm të drunjve, tek gardhi kemi ritëm të formave të ndryshme, te shkallët kemi shkallë pas shkalle, e cila përsëritet, si dhe shumë sende tjera, të cilat janë prezente rreth nesh. Gjithë këtë ne mund ta paraqesim me vizatim.



Ritëm i shkallëve




Ritëm i formave



Ritëm i vijave



Ritëm i ngjyrës dhe vijës



Ritëm i ngjyrës

BARASPESHA

Themi se baraspesha është në gjitha anët rreth nesh, në natyrë, te njerëzit dhe në art. Edhe në vizatim, po ashtu mundohemi të arrijmë baraspeshë të asaj që e paraqesim në anën e djathtë dhe të majtë të veprës. E dimë se baraspesha në mënyrë më të thjeshtë paraqitet me simetri, por edhe me asimetri.

Në natyrë ekzistojnë forma, të cilat prej vetes janë simetrike, respektivisht ana e djathtë dhe e majtë e tyre janë identike. Këtë më së lehti e vërejmë nëse vizatojmë flutur, vazo, shishe apo portret të ndonjë njeriu në anfas.

Shohim se të dy anët e këtyre formave janë identike, respektivisht simetrike.



Vepër me simetri




Vizatim me tush të dredhur (asimetri)



Vizatim i fëmijëve, flomaster (asimetri)



Vizatim me tush të dredhur (asimetri)



Krijim i fëmijëve (simetri)



Vizatim kompjuterik (simetri)

TUSH

Për vizatim përdoren materiale të ndryshme, siç është lapsi, tushi, flomasteri, thëngjilli e mund të vizatohet edhe me ngjyra të ujit.

Tushi është material i lëngshëm për shprehje figurative. Mund të jetë i zi, por ekziston edhe tush me ngjyra të ndryshme. Vizatohet në letër të lëmueshme, më së shpeshti në hamer, për këtë shkak se baza nuk e thith tushin menjëherë dhe nuk e shpërndan.

Si vegla për vizatim me tush përdoren penda, dru i mprehur apo brushë me maje. Secili nga këto materiale lënë gjurmë specifike me kualitete të posaçme figurative.

Me tush mundemi ta paraqesim çdo detal të asaj që e vizatojmë. Vizatimin me pendë mund ta kombinojmë edhe me brushë. Kur e mbarojmë vizatimin me pendë, me brushë mund të vendosim tush të holluar dhe me këtë ta mbulojmë gjithë vizatimin me hapësira më të errëta apo më të ndritshme sipas dëshirës. Këtë lloj vizatimi e quajmë tush të dredhur apo vizatim me tush të dredhur.

Bajci është teknikë e ngjashme si tushi, vetëm se ai ka ngjyrë specifike kafe-oker. Me bajc punohet në mënyrë të njëjtë sikur se me tush.

Vizatimi me bajc apo tush, më së shumti takohet me ngjyrë të zezë-hiri apo kefe-oker. Kur vepra është punuar me ton të ngjashëm, themi se është vizatim monohrom, e ajo do të thotë se nuk kemi përdorur më shumë ngjyra të ndryshme gjatë vizatimit.



Portret njeriu, tush, pendë




Dru me degë, tush-pendë



Vizatim i dredhur, tush



Vegla për vizatim me tush



Gjurmë nga penda të ndryshme

Sferë shumë e njohur, e ndoshta edhe më e pranishme në artin figurativ është pikturimi. Pikturimi si zonë paraqitet me vepër figurative, të cilën e quajmë pikturë. Piktura është karakteristike se është e ngjyrosur me ngjyra të ndryshme, sipërfaqe, forma dhe vija.

Piktura përjetohet me shikim vizuel, ndërsa shumë rrallë me prekje.

Piktura paraqitet me vënien e ngjyrës në bazë të caktuar. Ngjyrat janë të punuara nga pigmente (ngjyrë pluhur) të cilat përzihen me ndonjë lëng, që të mundet të pikturohet. Në këtë mënyrë janë krijuar ngjyrat akuarel, tempera dhe ngjyrat e yndyrshme, të cilat i shfrytëzojnë artistët figurativ. Sipas kësaj si është përgatitur pigmenti kemi edhe teknika të ndryshme të pikturimit: akuarel, tempera, akril, kolazh, freska, teknika të yndyrshme, vitrazh dhe tapiseri.

Artistët i vendosin ngjyrat në pikturë me brushë. Brushat bëhen nga fije speciale të ndonjë kafshe, ndërsa sot edhe nga materiale artificiale. Kemi lloje të ndryshme të brushave me maje të mprehtë apo të rrafshtë, të rrumbullakëta apo të shtypura. Brushat dallohen edhe sipas madhësisë. madhësia shënohet me numër.

Piktura ka edhe bazë në të cilën pikturohet. Baza për pikturim mund të jetë letër, pëlhurë, mur, dru ose qelq.



Brusha për pikturim



Pigmente nga të cilat bëhet ngjyra



Leonardo da Vinçi: **Mona Liza**, vaj në pëlhurë



Miroslav Masin: **Nga cikli i transformimeve**, vaj në pëlhurë



Dushko Stojanovski: **Tapiseri**



Sezan: **Mali Sent Viktori**,
Vaj në pëlhurë



Zbritja e Krishtit nga kryqi, freska nga Nerezi



Bogorodica, ikonë, Ohër

NGJYRA

Piktorët në veprat e tyre më së shumti përdorin ngjyrën në kombinim me elementet të tjera të gjuhës figurative.

E dimë se ngjyrat ndahen në primare dhe sekondare, të ngrohta dhe të ftohta, të ndritshme dhe të errëta, hromatike dhe ahromatike.

Hromatike janë ngjyrat primare dhe sekondare, e ahromatike janë e zeza dhe e bardha me të gjitha tonet që fitohen me përzierjen e tyre. Të gjithë ne pikturojmë me ngjyra të cilat na pëlqejnë.

Nëse duam që ndonjë ngjyrë të jetë më e bukur dhe e shfaqur, e përdorim kontrastin komplementar. Në këtë kontrast çifte komplementare janë: kuq-gjelbër, kaltër-portokalle, verdh-vjollcë.

Shumë artistë përtathtëksuar bukurinë e ngjyrave në veprat e tyre kombinonjë çiftet komplementare.

Sikur se te vizatimi, nëse në pikturë përdorin një ngjyrë me tone të ndryshëm themi se piktura është monochrome, e nëse pikturojmë me shumë lloj ngjyrash intensive themi se piktura është koloristike.



Kostas Gjeorgiu: **Stasis II**, vaj në pëlthurë



Svetlin Rusev: **Zgjedhje e civilizimit**, vaj në pëlthurë (monochrome)



Vasko Tashkovski: **Rrënjët e malit**, vaj në pëlthurë (koloristike)



Petleski: **Rajon i djegur**, vaj në pëlthurë (koloristike)



Kompozim koloristik

GRADACION

Në gjuhën figurative u ndeshëm me shprehjen gradacion. Ai është ndryshimi gradual i vijës, ngjyrës apo formës nga një vlerë në tjetër.

Në pikturim, shpesh herë takohemi me përdorimin e gradacionit.

Artistët në pikturat e veta me gradacion të ngjyrës dhe tonit na paraqesin iluzion të hapësirës gjatë paraqitjes së natyrës, na paraqesin iluzion të vëllimit të objekteve, respektivisht llojllojshmërinë dhe bukurinë e ngjyrës dhe tonit, si dhe pasurinë e ndjenjës sonë.



J. Mishe: **Vajzë**, vaj në pëlhurë (gradacion me ton)



Gradacion me ton



Gradacion me ngjyrë



Sveto Manev: **Vizatim-pikturë**, (gradacion me ton)



L. Popoviq: **Homazh**, vaj në pëlhurë (gradacion me ton)



Gradacion me ngjyrë

GVASH

Nxënësit, por edhe artist të caktuar, veprat e tyre figurative i punojnë me teknikë gvash.

Gvash është teknikë e pikturimit më ngjyra të lëngshme në të cilën përdoren ngjyrat akuarel(të ujit) dhe temperë e bardhë. Trashësia e ngjyrës varet nga sasia e temperës së bardhë që shtohet.

Sipas idesë figurative, me gvash mund të fitohet sipërfaqe e lëmueshme apo e vrazhdë, e pikturuar në mënyrë intenzive apo të ngadalësuar, ngjyra e vendosur, e tejdukshme apo mbuluese, e theksuar apo rritje graduale e tonit.

Për punim me gvash na nevojiten: ngjyra akuarel, temperë e bardhë, brusha: të gjera, flah-brusha për sipërfaqe të mëdha, më të vogla dhe më të mëdha me maje të theksuar me të cilën pikturohet. Brusha duhet të ketë mundësi të thithë dhe të mbajë sasi të ngjyrës, të lakohet gjatë prekjes me bazën pa u ndarë fijet dhe të ketë maje të theksuar dhe butësi. Nevojitet edhe: dy gota(për ujë të pastër dhe të papastër), paletë (pjesë plastike apo druri) për përzierjen e ngjyrave, fletë letre të bardhë për provë të ngjyrës dhe leckë për t'i pastruar brushat gjatë punës.

Me gvash mundet të punohet drejtpërdrejt me ngjyra ose, së pari, të vizatohen konturat me laps. Lapsi duhet lehtë të shtypet dhe më rrallë të fshihet që të mos dëmtohet letra, nuk është e nevojshme të vizatohen detaje të vogla dhe hijëzim me laps, sepse ngjyra do ta mbulojë vizatimin dhe mund të jetë e papastër.



Fëmijë pikturojnë me gvash



Vepër me gvash



Vepër e fëmijëve, gvash



Vepër e fëmijëve, gvash

Portret,
vepër e fëmijëve, gvash

KOLAZH

Kur vizatojmë dhe pikturojmë, mundemi të kombinojmë edhe sipërfaqe të tjera të ngjyrosura të cilat do t'i ngjitem në vizatim ose pikturë. Kur bëjmë vepër figurative me ngjitje të sipërfaqeve të ngjyrosura nga materiale të ndryshme, themi se ajo teknikë është kolazh.

Kur kombinojmë vizatime dhe kolazh me sipërfaqe të tjera, themi se kemi vizatim të kolazhuar, e kur kombinojmë pikturim me kolazh, themi se kemi pikturë të kolazhuar.

Për kolazh mundemi të shfrytëzojmë sipërfaqe të ngjyrosura nga materiale të ndryshme, nga letra, tekstili, teksturë nga letra, pjesë të fotografive ose sipërfaqe të ngjyrosura apo tekstuale të materialeve tjera të shtypura. Në kohët më të reja për kolazh përdoren edhe materiale tjera, të cilat i përdorim në jetën e përditshme.

Secili autor zgjedh se me çfarë ngjyre, madhësie dhe forme do ta kombinojë veprën e tij. Gjith sipërfaqet e ngjyrosura, ngjiten dhe kombinohen në sipërfaqe të letrës në një kombinim, i cili krijon një tërësi.



Fatlice Veseli: **Hije**, kolazh



Vepër me kolazh



Vegla për punim me kolazh



Kolazh me sipërfaqe të ngjyrosura dhe tekstuale

Grafika është sferë figurative, të cilën e hasim në artin figurative.

Grafika dallohet nga vizatimi dhe pikturimi se veprat grafike krijohen me anë të shtypit në teknika dhe materiale të ndryshme. Vepra e punuar në grafikë po ashtu quhet gragikë ose fletë grafike, e artisti graficist. Në grafikë autori nuk vizaton drejtpërdrejt në letër, që të fitojë grafikë si vepër figurative.

Në këtë zonë graficisti, së pari, bën skicë për veprën e tij e pastaj në ndonjë pllakë e nxjerr idenë. Pllaka mund të jetë nga materiale të ndryshme, nga druri, linoleumi apo metal. Atë pllakë, të cilën e quajmë matricë, autori e thellon, e gërvisht apo me kemikali e përpunon dhe pasi që ta lyejë me ngjyrë e shtyp grafikën, me dorë apo me makinë për shtyp.




Direr: **Shën Toma**, gravurr



Punim me pllakë guri për litografi



Makinë për shtyp



Dushan Perçinkov: **Rajon romantik**, sito-shtyp



Vepër e fëmijëve, gdhendje linoleumi



Bozhin Barutovski: **Vrimë**, gdhendje linoleumi



Danço Ordev: **Akt**, litografi



Ilija Kočovski: **Bukuroshja dhe bisha**, gdhendje druri



Gdhendje linoleumi



Vepër studentore, gdhendje linoleumi



Detska tvorba, gdhendje linoleumi



Fatmir Krupa: **Kompresion**, akvatinta

MONOTIPIA

Monotipia është teknikë e grafikës që mundëson fitimin e vetëm një gjurme. Për këtë shkak secila gjurmë është e vetme dhe e papërsëritshme.

Për realizim të monotipisë aplikohet pllakë e rrafshhtë qelqi, plastike apo metali më e madhe se fleta në të cilën shtypet. Mbi pllakën, e cila përdoret, me brushë vendoset ngjyra e dëshiruar apo më tepër ngjyra, sipas dëshirës dhe deri sa është e lagur mbi të e vëmë fletën. Gjithë sipërfaqja e fletës shtypet me dorë deri sa nuk bie mbi pllakë dhe e thith ngjyrën. Pastaj hiqet fleta: me dy gishta, me të dy duart kapim dy skajet lartë të letrës dhe e ndajmë nga pllaka. Me këtë shtypi është i gatshëm.

Në monotipi mund të punohet me një ngjyrë si vizatim apo me sipërfaqe të plotësuara, me dy apo më tepër ngjyra, me gradializim tona, me motiv dhe pa motiv, me gërvishtje të ngjyrës etj.

Monotipia është teknikë tërheqëse e grafikës për artist me afinitete pikturimi.

Bazë për shtypjen e monotipisë më së shpeshti është letra, por mund të shtypet edhe në tekstil apo material tjetër sipas dëshirës.



Monotipi



Monotipi



Vepër me monotipi me më tepër ngjyra



Procesi i shtypjes së monotipisë



Vepër me monotipi në një ngjyrë

KARTON - SHTYP

Karton-shtyp është teknikë grafike e shtypit të lartë. Si bazë për shtyp përdoret kartoni. Nga kartoni përpunohet matrica, e cila na shërben për shtypjen e grafikës.

Së pari, merren dy pllaka kartoni të njëjta. Në njërën vizatohen format e dëshiruara, priten dhe ngjiten në kartonin tjetër. Kur të përpunohet matrica në të vihet ngjyrë e pastaj fletë letre, shtypet me ndonjë trup cilindrik në letër dhe fitohet gjurma.

Në këtë teknikë, në matricë mund të ngjitet edhe material tjetër sipas dëshirës, me të cilët do të fitohen efekte të papritura dhe interesante të gjurmës.



Vepër e fëmijëve, karton-shtyp



Vepër e fëmijëve, karton-shtyp



Vepër e fëmijëve, karton-shtyp



Proces i punës me karton-shtyp



Materiale për punë me karton-shtyp

Skulptura është sferë figurative veprat e së cilës janë të krijuara nga materiale të buta dhe të forta të cilat marrin hapësirë. Kjo zonë quhet formësim plastik, e artisti quhet skulptor.

Skulptura përpunohet me materiale të ndryshme, të cilat kanë karakteristika dhe bukuri të veta. Materiale më të shpeshta për përpunimin e skulpturave janë guri, druri, metali dhe qeramika.

Krahas materialeve klasike në skulpturë punohen vepra nga letra, plastika e deri te materialet të përdorura.

Varësisht nga ajo se nga cili material punohet skulptura, kemi edhe hapa të ndryshëm të formësimit, siç është shtimi dhe marrja, ndërtimi, thellësimi, gërvishtja dhe performimi i materialit, me ngjitje dhe bashkim, me lidhje dhe thyerje.

Skulpturën e hasim si plastikë të plotë, të cilën mund ta shikojmë nga të gjitha anët, si reljef, i cili është vënë në ndonjë sipërfaqe të murit apo të lirë vertikale, si bust, i cili paraqet portret të ndonjë personi, kompozim i disa skulpturave të veçanta.

Në skulpturë janë të pranishme të gjitha parimet figurative, të cilat veprën figurative e bëjnë kualitative e ato janë: vëllimi, vija, tekstura, proporcioni, ngjyra etj.



Venera Vilendorska, skulpturë guri



Reliev, Egjipt



Vlado Avramçev: **Cikël rajone**, qeramikë



Skulpturë mobile në hapësirë



Vencislav Rihter: **H-1**, aluminium

FORMA

E dimë se forma është pamja e jashtme e sendeve, që i shohim dhe i paraqesim. Skulptura është formë tredimensionale, e cila merr hapësirë të caktuar, respektivisht ka vëllim. Nëse ai vëllim është i mbushur me material, themi se kemi masë. Masa është material, i cili e merr hapësirën. Skulptura e mbushur me material ka sasi të njëjtë vëllimi dhe mase.

Guri ka vëllim dhe masë të njëjtë, e baloni ka vëllim të madh e masë shumë të vogël (material).



Skulpturë prej letre



Ikonostas në kishën Sh. Dimitrie,
Manastir, drugdhendje



Figurë nga argjili i pjekur, Jerusalem



Mikelanxhelo: **Mojseu**, gur

BARASPESHA

Sikur se në zonat të tjera figurative, edhe në skulpturë baraspeshë arrijmë me simetri dhe asimetri, respektivisht baraspeshë vizuele të anës së majtë dhe të djathtë të veprës.

Në skulpturë më tepër zbatohet (aplikohet) baraspesha asimetrike.




Përmendore **Makedonium**, Krushevë
(simetri)



Oto Logo: **Relikvija**, metal
(simetri)



Marijeta Sidovska: **Kërkoj njeri në pasqyre**, teknikë e kombinuar(asimetri)



Stefan Manevski: **Skulptura H-1**, metal (asimetri)



B. Veličkovski: **Torzo**, terakota
(simetri)



Koka e perëndeshës nga Jabolce, Shkup (simetri)

NGJYRA

Ngjyra në skulpturë është e pranishme që nga parahistoria e deri më sot. Janë zbuluar shumë vepra me gjurmë të ngjyrës me çka potencohet bukuria e skulpturës. Sot, shumë skulptorë bashkëkohorë veprat e tyre i kombinojnë me ngjyrë.



Radovan Tërnavac: **Formë artistike**, dru (skulpturë e ngjyrosur)



Reliev i ngjyrosur



Tutankamon, Egjipt, skulpturë e ngjyrosur



Perëndesha Nepal, skulpturë e ngjyrosur



Jordan Grabulovski:
Paradoks i koekzistimit



Skulpturë bashkëkohore

PROPORCIONI

Artistët çdo herë janë munduar të paraqesin bukuri në veprat e tyre, e më së shumti bukurinë e trupit të njeriut. Në periudhë të caktuar të historisë, posaçërisht në artin grek, kanë ardhur deri te raportet ideale për paraqitjen e njeriut.

Proporcioni është parim figurativ, i cili studion raportin ndërmjet madhësive, respektivisht detajet në një tërësi.




Aleksandar Kalder: **Kali**, tel



Praksitel: **Venera**, Greqi, gur



Skulpturë greke, proporcion



Mikelanxhelo: **Pieta**, detal, gur



Umetnik od Hopeh: **Statua e Arhatit**, qeramikë e ngjyrosur



Dragan Popovski-Dada: **Postier**, mermer

FORMËSIM

SFERA FIGURATIVE

75

KOMPOZIM

Secila vepër artistike është e përbërë nga shumë gjëra të bashkuara në një kompozim. Në skulpturë kemi kompozim të shumë vëllimeve të thjeshta në një vëllim të ndërlikuar, ose nga më tepër skulptura të pavarura në një tërësi të quajtur asambrazh.

Nëse skulptura është e vënë në hapësirë të hapur, ajo duhet të jetë e lidhur me mjedisin në një tërësi kompozimi. Secili skulptor kur krijon vepër për hapësirë të caktuar, mendon se si të jetë ajo skulpturë që të adaptohet në mjedis.



Tome Serafimovski: **Qiril dhe Metodij**, bronzë



Jordan Grabulloski: **Shenja vendore**, cement i bardhë



Vasil Vasilev: **Formë asociative vertikale XII i VIII**, dru



Kalder: **Familje**, tel



Jordan Grabulovski: **Komunikimi II**, teknikë e kombinuar

DIZAJN DHE KOMUNUKIME VIZUELE

SFERA FIGURATIVE

76

• Komunukimet vizuele dhe dizajni përfshijnë pamjen e plotë të gjithë asaj që mund të shihet rreth nesh dhe i shërben njeriut në jetën e përditshme për mbijetim, ekzistencë dhe zbavitje. Dizajni është formësim i pamjes së jashtme të sendeve rreth nesh, respektivisht sendeve që i përdorim.

• Komunukimet vizuele janë ato nëpërmjet të cilave njeriu komunikon me të tjerët rreth vetes, si për shembull: libra, katalogë, shenja komunikacioni, revista, gazeta, reklama, shpallje, plakate, ilustrime etj.

• Në komunikim vizuel plakati është pjesë e pazëvendësueshme e këmbimit të informatave dhe ideve. Me mundësinë të prezentojë tekst dhe fotogravi njëkohësisht, plakati paraqet një nga bartësit të drejtpërdrejtë të porosive vizuele: për koncerte, prodhime, ekspozita, fushata, manifestime të ndryshme etj. Artistët, të cilët formësojnë komunikime vizuele, i quajmë *dizajnerë grafikë*.

• Në komunikimet vizuele rol kryesor ka zbatimi i fotografisë. Sot kompjuteri është mjet kryesor për kombinim, zbulim dhe krijim të veprave interesante dhe tërheqëse.




DIZAJN MODE



DIZAJN INDUSTRIAL



DIZAJN INDUSTRIAL



PLAKAT



PLAKAT

DIZAJN DHE KOMUNUKIME VIZUELE

SFERA FIGURATIVE

60



REVISTË



REVISTË



REVISTË



PLAKAT



STOLI



STOLI



PLAKAT



SHENJË

77



Gjorgji Zografski:
Portret gruaje,
Vaj në pëlhurë



Dimitar
Andonov-
Papradishki:
Pejsazh,
vaj në pëlhurë



Dimitar Avramovski Pandilov: **Korrëset,** vaj në pëlhurë



Ljubomir Belogaski: **Motiv nga Boka II,** akuarel



Ljazar
Liçenoski:
Dolap,
vaj në pëlhurë



Vangel
Koxhoman:
**Motiv nga
Prilepi I,**
vaj në shperpflake




Nikolla Martinovski: **Nuse**, vaj në pëlhurë


Angele Ivanovski:
Shkupi i vjetër,
vaj në pëlhurë




Mile Korubin: **Kombinim**, vaj në pëlhurë



Borko Lazeski:
Apstrakcion, tempera



Dima Todorovski:
Nëna e artistit bronz



Borisllav Trajkovski:
Kombinim, vaj në pëlhurë

A

Amater – dashamir i artit, i cili ka profesion tjetër, por merret me krijimtari figurative nga dashuria

Animalist – artist figurativ, i cili merret me paraqitjen, respektivisht vizatimin e kafshëve.

Antika – emër i kulturave të vjetra, posaçërisht ajo romake dhe greke.

Art apstrakt – drejtim në artin modern, i cili largohet nga paraqitja e botës reale dhe krijon me forma të lira.

Arabeska – ornament në stil arab, i cili përbëhet nga elemente të stilizuara gjeometrike

Atelje – punëtori, vend pune për artist figurativ dhe profesione kreative

Ambalazh – dizajnim figurativ në të cilin paqetohet dhe shitet prodhimi.

Art figurativ – emër i përbashkët për arkitekturë, pikturë, skulpturë dhe grafikë, vepra të cilat njeriu në mënyrë kreative i krijon.

Art i zbatueshëm – emër i objekteve të formësuara për qëllim përdorimi.

B

Bareljef – reljef i ulët dhe i cekët në skulpturë

Bienale – ekspozitë, e cila mbahet në çdo dy vite

Bust – paraqitja e kokës dhe pjesës së sipërme të trupit të njeriut në skulpturë.

F

Faktura – sipërfaqe e veprës artistike në pikturë me të cilën fitohen disa dukuri në sipërfaqe.

Figurativitet – karakteristikë e veprës figurative kur në të mund të shihet fytyrë konkrete, përmbajtje apo motiv.

Fletë grafike – vepër grafike figurative e shtypur.

G

Galeri – hapësirë e ndërtuar për eksponim të veprave artistike.

Gvash – teknikë për vizatim me ngjyra uji dhe temperë të bardhë.

Grafikë reproduktive – kopje apo vepra, të cilat nuk janë të shtypura manuelisht, por me shtyp ofsetindustrial.

D

Dekoracion – stoli, respektivisht stolisje e hapësirës dhe formave për stolisje.

Dizajn – vizatim i dedikuar për formësim të prodhimeve për prodhim industrial.

Dizajn industrial – formësim figurativ për përdorim të përditshëm, që prodhohen në industri.

Dizajner – artist, specialist për formësim estetik të objekteve dhe sipërfaqeve për prodhim industrial.

H

Histori e artit – shkencë për paraqitjen dhe zhvillimin e drejtimeve artistike, vlera dhe domethënia e tyre historike.

I

Ilustrim – pikturë apo vizatim lidhur me ngjarjen e tekstit të shkruar.

Iluzion – iluzioni në pikturim është paraqitje e hapësirës, tonit, perspektivës etj.

K

Katalog – publikim në të cilin janë të shënuara të gjitha veprat e eksponuara në muze, galeri, ekspozitë ose krijimtaria e artistit.

Kiç – produksion joartistik. Kiç është vepër, e cila është krijuar për dëshira të lira, paraqitet si rezultat i rrethinës së pazhvilluar artistike.

Kolorit – ngjyrosje, dukuri, shprehje, efekt i veprës artistike i arritur me ngjyrë.

Kroki – vizatim i shpejtë dhe i lehtë me vija të thjeshta dhe pak detaje.

L

Lineare – karakteristikë e pikturimit, skulpturimit apo veprës grafike në të cilën kryesisht mjet i shprehjes është vija.

M

Marina – paraqitje artistike e pejsazheve detare.

mbështjellës – mbështjellje figurative, dizajnim i kopertinave të librit apo ndonjë material tjetër reklamimi.

Minijaturë – pikturë apo skulpturë në format të vogël.

Mozaik – vepër artistike, e cila punohet me bashkimin e katrorëve të gurit apo qelqit në ngjyra të ndryshme.

Monografi – libër në të cilin janë paraqitur jeta dhe vepra e ndonjë artisti.

Monohromi – vepër artistike e punuar me një ngjyrë.

N

Naturalizëm – përpjekja e artit që dukuritë dhe objektet të paraqiten në mënyrë më reale dhe objektive.

Ngjyrë Lazure – vendosje e ngjyrës në mënyrë të tejdukshme nëpërmjet të cilës mund të shihet baza.

O

Ornament – format gjeometrike, bimore ose zoomorfe të stilizuara me të cilat është stolisur ndonjë sipërfaqe, që mund të përsëriten ose të ndryshojnë.

P

Paletë – sipërfaqe në të cilën përzihen ngjyrat para se të vendosen në vepër.

Panoramë – paraqitje e natyrës me pamje të gjera dhe të largëta.

Pejsazh – pikturë e cila paraqet natyrën.

Profil – pamje e fytyrës apo sendit të shikuara prej anash.

S

Signatura – nënshkrim i artistit në pikturë, grafikë apo skulpturë të cilën e ka punuar.

Skicë – pikturë, skulpturë apo ndërtim i parregulluar i formuar në mënyrë të shpejtë.

Skulpturë e galerisë – skulpturë, e cila me madhësinë e vet, mund të ekspohet në galeri (madhësi reale dhe minijature).

Stilizacion – thjeshtësim i formave nga natyra në forma të thjeshta.

Sh

Shtafelaj – këmbëz pikturimi, mbajtës në të cilën vendoset piktura gjatë punimit.

Shtyp i rrafshhtë – teknikë grafike pa thellësim të bazës (sito-shtyp, monotipi, litografi).

T

Tapiseri – emër i përgjithshëm për vepër artistike të punuar nga tekstili.

Terakota – emër i përgjithshëm për prodhime nga argjili, të cilat janë fortësuar me pjekje.

Triptih – vepër figurative e përbërë nga tre pjesë.

V

Valer – fjalë frengje për ton.

Vinjeta – vizatim i vogël apo pikturë, e cila shërben për stoli të ndonjë teksti.

Vitrash – dritare apo sipërfaqe qelqi, e punuar apo stolisur me pjesë qelqi me ngjyra të ndryshme.

Vizatim – vepër figurative e krijuar me vija si mjet kryesor i shprehjes.

Zh

Zhanr – paraqitje e fotografive të jetës së përditshme nëpërmjet krijimtarisë figurative.

TEST 1

82



Nxënës i dashur,

Kur të arrish deri te këto teste, je njohtuar me numër të madh të përmbajtjes të këtij libri. Deri më sot me siguri ke mësuar mjaft gjëra të panjohura, e disa i ke ditur.

Këto teste janë vetëm kontroll i diturive tua.

Disa pjesë të tekstit janë me përgjigje të pyetjeve të parashtruara, e disa zgjedhen me vizatim. Shpresoj se testet nuk janë të rënda dhe pa mund të madh do ti zgjedhësh.

Testet do t'i plotësosh atëherë kur të vendosë arsimtari i artit figurativ, të parin nga fund i gjysëmvjetorit të parë, e të dytin nga fund ii gjysëmvjetorit të dytë. Përgjigjet e secilës pyetje do të notohen me pikë, të cilat do t'i caktojë arsimtari i artit figurativ. Testet janë krijuar në atë mënyrë që të mund të shkëputen dhe t'i dorëzohen arsimtarit për notim. Të dëshiroj zgjedhje të suksesshme të testeve, nota të mira dhe kënaqësi gjatë punës.

EMRI DHE MBIEMRI _____

KLASA _____

SHKOLLA _____

DATA _____

1. A ke ndonjëherë dëshirë të vizatosh?

- ☐ po
☐ jo

2. A di teknika të ndryshme të vizatimit?

- ☐ po
☐ jo

3. A do më shumë; të vizatish, pikturosh apo modelosh ?

- ☐ Të pikturoj
☐ Të vizatoj
☐ Të modeloj

4. Rretho teknikat e pikturimit:

- ☐ Tush pendë dhe ☐ laps
☐ pastel ☐ kolazh
☐ akuarel ☐ tempera

5. Kur shikon pikturë, a zgjon në të interes dhe a ndalesh ta shikosh ?

- ☐ po
☐ jo
☐ ndonjëherë
☐ nuk më intereseon

6. Përshkruaj çka është skulptura?

TEST 1

84

7. Numëro nga cilat materiale mund të punohet skulptura.

8. A e di se çka është grafika?

9. A mundesh të vizatosh ndonjë shenjë apo amblem të njohur?

10. A ke vizituar ndonjë muze apo galeri deri tash dhe trego se ku?

11. Numëro disa emra të artistëve figurativ vendorë.

12. Numëro disa emra të artistëve figurativ botërorë.

13. A ke parë vepër artistike në vendin ku jeton dhe nëse e di trego prej kujt?

14. Shkruaj se në cilën zonë figurative bën pjesë reljefi.

TEST 2

85


EMRI DHE MBIEMRI _____

KLASA _____


SHKOLLA _____

DATA _____


1. Vizato formë me vijë konturale.




Vizato formën e njëjtë me vijë teksturale.





2. Përpiqu që me temperë të vendosësh ngjyrë të gjelbër në katrorin e brendshëm dhe ngjyrën e saj komplementare në katrorin e jashtëm.



3. Përpiqu me temperë të vendosësh ngjyrë në katrorin e brendshëm dhe ngjyrën e tij komplementare në katrorin e jashtëm.



3. Vizato forma me ritëm të rregullt në njërin dhe ritëm alternative na katrorin tjetër.




TEST 2


86 5. Cila nga dy pikturat të pëlqen më tepër?




6. Vizato grup formash me kahje të pjerrët.




7. Vizato grup formash në kompozim horizontal.



8. Paraqit bashkësi me forma të ngjashme.



9. Vizato diçka sipas dëshirës.



100

[illegible]

